

V E N D I M
Nr.12, datë 28.5.1997

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Hilmi Dakli,	Anëtar i	“““
Veli Budo	Anëtar i	“““
Zija Vuci,	Anëtar i	“““
Franc Jakova,	Anëtar i	“““
Alfred Karamuco,	Anëtar i	“““
Ha1il Kopani,	Anëtar i	“““
Kristofor Peçi,	Anëtar i	“““

me sekretare Drita Filto, më datë 7.5.1997 mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.17 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: AGIM SHEHU, i përfaqësuar nga Av.Sadedin Xhafa.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KËSHILLI I MINISTRAVE, i përfaqësuar nga Av.Thimjo Kondi.

2. PRESIDENTI I REPUBLIKËS, i përfaqësuar nga këshilltari juridik Z.Ilirjan Rusmali.

O B J E K T I:

Deklarimin antikushtetues të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.168, datë 19.4.1997 për lirimin e kërkuesit Agim Shehu nga detyra e Zëvendësministrit të Brendshëm dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, në bazë të nenit 28 pika 19 të ligjit "Për dispozitat kryesore kushtetuese" dhe nenit 32 të ligjit nr.7978, datë 26.7.1995 "Për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë".

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi kërkuesin, subjektet e interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Këshilli i Ministrave me vendimin nr.168, datë 19.4.1997 ka liruar kërkuesin Agim Shehu nga detyra si Zëvendësministër i Brendshëm dhe Drejtor i Përgjithshëm i Policisë pa përmendur motivacionin, por duke u shprehur se ky vendim bazohet në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.64, datë 5.2.1991 "Për emërtesat dhe procedurat për lëvizjen dhe emërtimin e specialistëve dhe drejtuesve në organet shtetërore dhe ekonomike".

Nga aktet vërtetohet se kërkuesi duke qenë oficer me gradë madhore është emëruar në detyrë me Dekretin nr.1287, datë 17.11.1995 të Presidentit të Republikës, i cili bazohet në nenin 32 të ligjit nr.7978, datë 26.7.1995 "Për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë".

Në këto kushte, Gjykata konstaton se ndodhemi para konfliktit të kompetencave sepse kërkuesi është liruar nga detyra nga Këshilli i Ministrave, kur kjo është në kompetencë të Presidentit të Republikës. Si rrjedhojë, në bazë të nenit 24 pika 5 të ligjit nr.7561, datë 19.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991" "Për dispozitat kryesore kushtetuese", çështja është në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

Dekreti i mësipërm i Presidentit të Republikës për emërimin në detyrë të kërkuesit, ka dalë në bazë dhe për zbatim të nenit 32 të ligjit nr.7978, datë 26.7.1995 "Për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë". Në paragrafin e dytë të këtij neni është përcaktuar: "Për oficerët aktivë me gradë madhore emërimi në detyrë, gradimi, transferimi, nxjerrja në rezervë dhe lirimi bëhet me Dekret të Presidentit të Republikës me propozim të Kryetarit të Këshillit të Ministrave".

Përsa i përket vendimit nr.168, datë 19.4.1997 të Këshillit të Ministrave, ky nuk mbështetet në ndonjë ligj të veçantë, por vetëm në një Vendim të Këshillit të Ministrave që i rregullonte ndryshe marrëdhëniet dhe veprimtarinë e administratës shtetërore.

Vendimi i Këshillit të Ministrave si akt nënligjor, nuk mund të rregullojë ose ndryshojë marrëdhënie të caktuara, të cilat janë vendosur me ligj.

Marrja e kompetencave të një organi tjetër, e bën vendimin e Këshillit të Ministrave të pavlefshëm.

Gjithashtu, Gjykata e quan të pabazuar edhe kërkesën tjetër të Këshillit të Ministrave për pezullimin e shqyrtimit të kësaj çështje, deri në zgjidhjen e një kërkesë tjetër të paraqitur prej tij për pakushtetutshmërinë e nenit 32 të ligjit nr.7978, datë 26.7.1995 "Për Forcat e Armatosura në Republikën e Shqipërisë".

Këshilli i Ministrave ka të drejtë të paraqesë një kërkesë të tillë, për shfuqizim të një dispozite ligjore si antikushtetuese dhe Gjykata Kushtetuese është e detyruar ta marrë në shqyrtim. Por, kjo kërkesë në këtë rast nuk mund të jetë shkak për pezullimin e shqyrtimit të kërkesës së mëparshme.

Gjykata arrin në këtë përfundim duke u bazuar në faktin se shqyrtimi i kërkesës për pakushtetutshmërinë e ligjit, nuk mund të ketë asnjë ndikim lidhur me paligjshmërinë e Vendimit të Këshillit të Ministrave. Ky vendim është i pavlefshëm se është nxjerrë në kundërshtim me ligjin, jashtë kompetencës lëndore të Këshillit të Ministrave, prandaj dhe nuk mund të sjellë asnjëherë efekte juridike.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 24 pika 3 e 5, 25 dhe 26 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me shumicë votash,

V E N D O S I:

Shpalljen të pavlefshëm të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.168, datë 19.4.1997, për lirin e kerkuesit Agim Shehu nga detyra e Zëvendësministrit të Brendshëm dhe Drejtor i përgjithshëm i Policisë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

Tiranë, më datë 28.5.1997

MENDIM PARALEL

Ndonëse jam i një mendimi me konkluzionin përfundimtar për pranimin e kërkesës së kerkuesit Agim Shehu, nuk jam dakord me motivacionin e vendimit të marrë.

Kerkuesi i vetëm është Agim Shehu dhe objekti i kërkesës është shfuqizimi i vendimit të Këshillit të Ministrave nr.168, datë 19.4.1997, si akt që cenon të drejtat e tij kushtetuese.

Megjithëse janë thirrur si subjekte të interesuara Këshilli i Ministrave dhe Presidenti i Republikës, asnjëri prej këtyre organeve të larta shtetërore nuk ka ushtruar kërkesë para kësaj Gjykate për zgjidhjen e mosmarrëveshjes për kompetencë (neni 24 pika 5 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 19.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese").

Në këto kushte Gjykata Kushtetuese nuk mund të nxjerrë konkluzionin se "ndodhemi përpara konfliktit të kompetencave". Ky lloj konflikti mund të shqyrtohet dhe zgjidhet vetëm me kërkesën e subjektit të caktuar që ka pretendime të pavarura lidhur me çështjen e kompetencës e që nuk pajtohen me pretendimet e një organi tjetër. Në përmbajtje ky konflikt mund të jetë pozitiv, (kur secili organ insiston se e ka çështjen e kompetencën e tij) dhe negativ, (kur secili prej tyre insiston se çështja nuk është në kompetencën e tij).

Është e vërtetë se lrimi i kerkuesit nga detyra nuk është në kompetencën e Këshillit të Ministrave, por në kompetencën ekskluzive të Presidentit të Republikës. Dhe pikërisht ky fakt e bën vendimin e Këshillit të Ministrave, të pavlefshëm. Por, përderisa vetëm kerkuesi e ka inicuar shqyrtimin e çështjes për të mbrojtur të drejtat e tij, vendimi i gjykatës duhet të motivohet vetëm për cenimin e të drejtës së tij kushtetuese për një proces të rregullt ligjor.

Me nenin 32 të ligjit "Për forcat e armatosura", është përcaktuar ndër të tjera mënyra e emërimit dhe lirit nga detyra e oficerëve madhorë. Sipas kësaj dispozite, Këshilli i Ministrave e ka vetëm të drejtën e propozimit, ndërsa Presidenti i Republikës të drejtën nxjerrjes së dekretit.

Në rastin konkret është shkelur ky proces i rregulluar me ligj që përbën një të drejtë të

pacënueshme të personit, e garantuar me nenin 38 të ligjit kushtetues për "Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut".

Së fundi, mendoj se edhe pjesa urdhëruese e vendimit duhej të përmbante pavlefshmërinë e vendimit të Këshillit të Ministrave, por vetëm pakushtetutshmërinë e tij. Pavlefshmëria këtu është vetëm shkak i pakushtetutshmërisë së aktit.

**KRYETARI
Rustem Gjata**

Tiranë, më 28.5.1997

MENDIMI I PAKICËS

Kërkesa e Z. Agim Shehu për shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.168, datë 19.4.1997 "Për lirinë e tij nga detyra e zv/ministrit të Brendshëm dhe Drejtorit të përgjithshëm të Policisë", nuk përbën objekt shqyrtimi për Gjykatën Kushtetuese.

Në radhë të parë, ky vendim, edhe thjeshtë si akt administrativ, aktualisht nuk ka fituar autoritet ligjor, për shkak të disa mangësive formale, që janë të domosdoshme për prodhimin e pasojave të tij juridike. Këto mangësi shfaqen në disa drejtime. Vendimi në fjalë nuk i është komunikuar personalisht kërkuarit, megjithëse është marrë në mungesë të tij dhe pa e thirrur e dëgjuar më parë. Akti ku është pasqyruar përmbajtja e tij për të cilin kërkuari ka marrë dijeni nga burime të tjera, nuk është nënshkruar nga Sekretari i përgjithshëm i Këshillit të Ministrave dhe as është sigluar nga Ministri propozues e Sekretari i Shtetit pranë Ministrisë së punëve të Brendshme, kërkesa këto të domosdoshme, të parashikuara nga paragrafi i parë i pikës 6.1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.136, datë 20.3.1995 "Për disa ndryshime të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.81, datë 6.2.1995 "Për rregullat e funksionimit të Këshillit të Ministrave".

Për më tepër, deri në këtë moment, sic doli nga shpjegimet në gjyq të përfaqësuesve të subjekteve të interesuara dhe të vetë kërkuarit, vendimi për shkarkimin e tij nga detyra nuk është dërguar për zbatim as në dikasterin ku ai ushtron funksionet e tij.

Prandaj, një akt i tillë është inekzistent, çështja është pa objekt dhe për rrjedhim Gjykata Kushtetuese nuk duhet dhe nuk mund të vendosë për zgjidhjen e saj në themel.

Së dyti, unë jam kundër pikëpamjes së pranuar nga shumica që e shqyrtoi dhe e zgjidhi këtë mosmarrëveshje, si konflikt kompetencash midis pushteteve, atij të Presidentit nga njëra anë dhe qeverisë së Pajtitit Kombëtar, nga ana tjetër.

Asnjëri prej këtyre organeve që kanë të drejtë të venë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese në bazë të nenit 25 të ligjit Kushtetues nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", nuk i është drejtuar asaj për zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshje.

Kërkesën e ka paraqitur vetëm kërkuari, por ky nuk përfshihet në rrethin e atyre subjekteve që në bazë të kësaj dispozite mund ta investojnë Gjykatën për shqyrtimin e çështjeve të kësaj natyre. Nga ana tjetër, kjo gjykatë nuk është shprehur paraprakisht se këtë çështje e merr në shqyrtim me nismën e saj .

Së treti, edhe sikur ky vendim i Këshillit të Ministrave, të marrë me vonë formën e kërkuar nga ligji dhe të fillojë të prodhojë efektet e veta, kërkuari duhet t'i drejtohet gjykatës së zakonshme, e cila është kompetente, në bazë të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, që këtë akt administrativ me karakter individual ta anullojë vetë, në qoftë se konstaton shkeljen e një të drejte kushtetuese ose çdo shkelje tjetër të së drejtës subjektive. Prandaj, Gjykata Kushtetuese, nuk ka pse të investohet me shqyrtimin e kësaj çështje dhe të marrë atributet e gjykatave të zakonshme.

Tirane, me 28.5.1997

**ANËTARI
Zija Vuci**

MENDIMI I PAKICËS

Nuk pajtohem me vendimin e shumicës për arsyet që poshtëradhis:

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.168, datë 19.4.1997 me të cilin është vendosur lirimi nga detyra e zëvendësiministri të Brendshëm dhe Drejtorit të përgjithshëm të Policisë, z. Agim Shehu, është një akt nënligjor i ndividual me karakter administrativ.

Sipas neneve 324, 325 dhe 326 të Kodit të Procedurës Civil, shqyrtimi i ankimeve kundër Vendimeve të kësaj natyre është në kompetencën e seksioneve administrative të krijuara pranë gjykatave të rretheve. Ndonjë përjashtim për këto raste nuk është parashikuar në ligj .

Në rastin e dhënë nuk del që ankuesit me këtë vendim t'i jetë shkelur ndonjë e drejtë kushtetuese e parashikuar nga dispozitat e ligjit nr.7692, datë 31.3.1993 "Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut". Por, po të lindëte ndonjë gjë e tillë edhe sikur nga ana e tij të bëhej një kërkesë e kësaj natyre prapë se prapë Gjykata Kushtetuese në këtë rast nuk është organ i juridiksionit fillestar .

Përderisa me ligj është parashikuar organi kompetent fillestar për shqyrtimin e këtyre konflikteve, Gjykata Kushtetuese, në zbatim të pikën 9 të ligjit të përmendur do të vihej në lëvizje për shqyrtimin e kësaj çështje. Pasi i interesuari të kishte konsumuar të gjitha hallkat e zakonshme kompetente për shqyrtimin e këtyre çështjeve.

Në nenin 28 të ligjit "Për dispozitat kryesore kushtetuese", janë të përcaktuara kompetencat kryesore të Presidentit të Republikës. E formuluar në këtë mënyrë kjo dispozitë kushtetuese jep të kuptojë se Presidentit të Republikës mund t'i jepen edhe kompetenca të reja me akte të tjera ligjore, të cilat ai i ushtron sipas numërit 9 të po atij neni, duke nxjerrë dekrete me karakter individual si dhe vendime të posaçme.

Një nga këto të drejta i është dhënë Presidentit edhe me ligjin nr.7978, datë 26.7.1995 "Për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", dhe konkretisht me paragrafin e dytë të nenit 32 të ligjit në fjalë, në të cilin thuhet shprehimisht se oficerët aktivë madhorë emërohen në detyrë, gradohen, nxirren në rezervë dhe në librim me dekret të Presidentit të Republikës mbi propozimin e Kryetarit të Këshillit të Ministrave. Në zbatim të kësaj norme juridike, Presidenti i Republikës me dekretin nr.1287, datë 17.11.1995 ka emëruar gjeneral major Agim Shehun, si zëvendësministër të Brendshëm dhe Drejtor i përgjithshëm i Policisë.

Nuk rezulton nga asnjë akt juridik kushtetues apo të zakonshëm e drejta e Presidentit të Republikës të emërojë në detyrë apo të lirojë nga detyra zëvendësministat qoftë edhe me propozimin e Kryetarit të Këshillit të Ministrave.

E drejta ekskluzive e Këshillit të Ministrave për të emëruar dhe libruar zëvendësministra e ka bazën në logjikën e thjeshtë të gjërave sepse buron nga parimet dhe fryma e përmbajtja e neneve 33 e 34 të ligjit nr.7491, datë 19.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", në të cilat bëhet fjalë në mënyrë të veçantë për "besimin politik" , "mocionin e mosbesimit" si dhe të përgjegjësisë kushtetuese politike të qeverisë dhe të anëtarëve të veçantë të saj .

Në raport me Këshillin e Ministrave kjo përgjegjësi për mendimin tim shtrihet edhe tek zëvendësministrat, të cilët kanë edhe të drejtën që në mungesë të ministrit të flasin dhe të veprojnë në emër të tij. Në këto raste si dhe për figurën e anëtarëve të qeverisë dhe të zëvendësave të tyre në plan të parë mbisundon parimi i "besimit politik dhe i përgjegjësisë konstitucionale" veç vetive cilësore të ministrit apo zëvendësministrit.

ANËTARI
Veli Budo